



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 889/prot.

Tiranë më 12.05.2022

Lënda: Dhënie mendimi për projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive’”.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2362/1 prot., datë 26.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 889 prot., datë 28.04.2022, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive’ (në vijim, “SEMDRK”)”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, vlerësojmë se, ndryshimet të cilat duhet të reflektohen në aktin nënligjor në fjalë janë si vijon:

Fillimisht, bazuar në nenin 5, pika b, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligjit”), si dhe pikën I/a, të Vendimit nr. 2, datë 10.3.2010, për “Përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë se, të dhënat mund të mbahen vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime, dhe përpunimi i tyre duhet të bëhet vetëm mbi bazën e këtyre qëllimeve sugjerojmë që në këtë kuadër, në përmbajtje të Kreut I, të projektvendimit të përfshihet një pikë e cila të identifikoj qartazi qëllimin e grumbullimit të të dhënave përmes këtij sistemi, sikurse është shpjeguar në relacionin bashkëlidhur.

Në përmbajtje të pikës 4, të projektvendimit, ku përcaktohet niveli i aksesimit, Zyra e Komisionerit sugjeron që, në zbatim të Ligjit, konkretisht neneve 5, 27 dhe 28 të tij, në këtë Kre të përfshihet një pikë me këtë përmbajtje:

*"Palët duhet të shkëmbejnë të dhëna personale në përputhje me qëllimin e grumbullimit të tyre, si dhe duhet të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çfardo forme tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përhapjen e të dhënave, etj, duhet të lerë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave".*

Me përmbushjen e sugjerimeve të mësipërme, projektvendimin vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

